

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarve M. P., nga fshati B., Komuna e Dragashit dhe I. P., nga fshati B., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale sulm ndaj personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 parag. 2 lidhur me parag. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 2312/15 të datës 08.09.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e Prokurores të shtetit në Prizren Mehreme Hoxha të akuzuarve, me datë 28.07.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.M. P. nga i ati R., e ëma N., e lindur K., i lindur më *data e lindjes...*, në Sh., R. e Maqedonisë, tani jeton në fshatin B., Komuna Dragash, ka të mbaruar arsimin fillor, i martuar, babai i 2 fëmijëve, elektrikist, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.I. P. nga i ati R., e ëma Sh., e lindur M., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin B., Komuna Dragash, ku dhe tani jeton, ka të mbaruar arsimin fillor, i martuar, babai i 3 fëmijëve, punëtor, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Se me datën 19.08.2015, rreth orës 21:25 min., në Prizren, në rr...., para objektit të D. R. të P. në Prizren, në bashkëveprim sulmojnë ose i kanosen seriozisht se do ti sulmojnë personat zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, lidhur me sigurinë e përgjithshme apo ruajtjen e rendit publik i cili rezultoi me lëndim të trupor, në atë mënyrë që derisa zyrtarët policor B. V., I. B., A. M., F. K., kanë qenë në asistencë të punëtorëve të pylltarisë duke siguruar shkarkimin e drunjtëve nga traktori i të pandehurve për vjedhje pylli të hasur nga Njësi Policor Vija e Gjelbër, të pandehurit fillojnë të fjalosen me zyrtarët policor e më pas i pandehuri M. P., e kap për uniforme zyrtarin policor – të dëmtuarit I. B., kurse i pandehuri I. P., e godet me grusht në pjesë e pasme të kokës zyrtarin policor, duke vazhduar që të dy të pandehurit duke e kapur për uniforme dhe shqyer uniformën e zyrtarit policor – të dëmtuarit, me ç'rast i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, dhe atë: ndrydhje të indeve të buta në kokë, qafë dhe në krahun e majtë, lëndime këto të përshkruara në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor të dt. 02.09.2015

Kësodore kanë kryer veprën penale sulm ndaj personave zyrtare gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 parag. 2 lidhur me parag. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, 49 paragrafi 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe nenit 410 parag. 2 lidhur me parag. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së të akuzuarve ju shqipton

Të akuzuarit të parë M. P.

DËNIM ME KUSHT

Vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I akuzuari i dytë I. P.

DËNIM ME KUSHT

Vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari I. B., nga Priyzreni, rruga ..., nr., për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në shumë prej 20 euro, në emër të ekspertizës mjeko ligjore si dhe të paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç shumen nga 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 2312/15 të datës 08.09.2015, kundër të akuzuarve M. P. dhe I. P., për shkak të veprës penale sulm ndaj personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 parag. 2 lidhur me parag. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Prokurori i shtetit Mehreme Hoxha, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.2312/2015 të datës 08.09.2015, kundër të akuzuarve M. P. dhe I. P., të dy nga fshati B., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje sulm ndaj personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 para. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu të akuzuarit në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranuan fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga e të akuzuarve në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë.

I akuzuari i parë M. P. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranoj veprën penale e cila më vihet në barë, në ditën kritike është vërtetë që kemi pasur një mosmarrëveshje me zyrtarin policor, emrin e të cilit nuk e di, kam vepruar në mënyrë jo të drejtë, faktikisht unë nuk kam qenë në vendin e ngjarjes, por më kanë lajmëruar me telefon që djali i vëllaut tim A. P. kishte pasur probleme me zyrtarët e pylltarisë, andaj me të ftuar me telefon unë kam shkuar në vendin e ngjarjes, me qëllim që të shiqoj si është situata me djalin e vëllaut. Kur arrita në vendin e ngjarjes, vërejtja edhe zyrtarët policor, të cilët ishin 4-5, mbeta i habitur nga kjo situatë, andaj pak i shqetësuar nga pamja që pash për djalin e vëllait, i rrethuar nga zyrtarët policor, në moment të efektit kam reaguar verbalisht, e pas kësaj nuk e di as vetë se si ka ndodhur një konflikt, dhe pas kësaj ka vazhduar procedura për shkak të veprës penale e cila më vihet në barrë. Më vie keq për veprën e kryer, pendohem thellë, kërkoj falje publike zyrtarit policor këtu të dëmtuar, por i propozoj gjykatës që të cekurat më lartë, që jam person familjar, babai i dy fëmijëve, kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana i propozoj gjykatës që të merr si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, e po ashtu faktin që kam ardhur enkas nga bota e jashtme duke punuar përkohësisht e vetëm e vetëm për ta zgjedhur këtë çështje penale, pra konsideroj që edhe bashkëpunimi im për zgjedhjen e kësaj çështje penale me organet kompetente konsideroj që është rrethanë lehtësuese.

I akuzuari i dytë I. P. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: unë në ditën kritike dhe në kohën kritike të cekur kam arritur pasi që më kanë telefonuar që djali im A. P., kishte pasur probleme me zyrtarët policor lidhur me disa drunj, të cilët kishin ardhur në asistim zyrtarëve të pylltarisë. Në momentin kur më kanë ftuar, kam shkuar në vendin e ngjarjes, dhe kur kam arritur e kam parë djalin tim të rrethuar me zyrtarët policor, andaj si çdo prind edhe në unë në atë moment e kam ndier vehten të shqetësuar, e po ashtu pak para meje kishte arritur edhe vëllau im M., i cili ishte duke biseduar me zyrtarët policor lidhur me ngjarjen, kërkonte sqarime për arsyet e ndalimit të djalit tim, e vërejtja që biseda në mes vëllaut tim dhe zyrtarit policor, ishte me tone të ngritura, e nga kjo si dhe nga situata si e pashë djalin tim, nuk kam mundur të kontrollojë veprimet e mia, andaj nuk e di as vetë si kam vepruar në ato momente, por tani pendohem plotësisht për veprimet e mia që e kanë shkaktuar veprën penale e cila më vihet në barrë, i kërkoj falje të dëmtuarit, publikisht sot para gjykatës pendohem thellë për veprën e kryer, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë të cekura më lartë, faktin që jam person familjar, jam babai i tre fëmijëve, kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, që jam mbajtës i vetëm i familjes time, dhe se me punën time të punëtorit jam i vetmi që sigurojë ekzistencën e familjes, andaj të gjitha këto të cekura, i propozoj gjykatës që të merre si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datën 19.08.2015, rreth orës 21:25 min., në Prizren, në rr. ..., të akuzuarit para objektit të D. R. të P. në Prizren, në bashkëveprim sulmojnë ose i kanosen seriozisht se do ti sulmojnë personat zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, lidhur me sigurinë e përgjithshme apo ruajtjen e rendit publik i cili rezulton me lëndim të trupor, në atë mënyrë që derisa zyrtarët policor B. V., I. B., A. M., F. K., kanë qenë në asistencë të punëtorëve të pylltarisë duke siguruar shkarkimin e drunjëve nga traktori i të pandehurve për vjedhje pylli të hasur nga Njësi Policor

Vija e Gjelbër, të pandehurit fillojnë të fjalosen me zyrtarët policor e më pas i pandehuri M. P., e kap për uniforme zyrtarin policor – të dëmtuarit I. B., kurse i pandehuri I. P., e godet me grusht në pjesë e pasme të kokës zyrtarin policor, duke vazhduar që të dy të pandehurit duke e kapur për uniforme dhe shqyer uniformën e zyrtarit policor – të dëmtuarit, me ç'rast i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, dhe atë: ndrydhje të indeve të buta në kokë, qafë dhe në krahun e majtë, lëndime këto të përshkruara në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor të dt. 02.09.2015

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarave të cilat në shqyrtimin kryesor vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarat kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila ju vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarat kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarave është bërë në pajtim me neni 248 të KPPK-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarave formohen të gjitha elementet e veprës penale sulm ndaj personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 parag. 2 lidhur me parag. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata nuk gjeti rrethanë rënduese, e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarave, pendimi i thellë i të akuzuarave, sjellja korrekte e të akuzuarve pas kryerjes së veprës penale, gjerë më tani të pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, komform nenit 74 dhe 75 të KPK gjykata mori parasysh rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarave, kanë bashkëpunuar vullnetarisht me gjykatën, kanë pranuar fajin, keqardhjen e shfaqur si dhe kanë pasur sjellje korrekte pas veprës penale të kryer, janë persona familjar, i akuzuari i parë është baba i dy fëmijëve kurse i akuzuari i dytë baba i tre fëmijësve, janë mbajtës të familjeve të tyre dhe se ekzistenca e familjeve të tyre varet nga puna e të njëjtëve, andaj gjykata ju shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se edhe me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj ju shqipton secilit veç e veç dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve, të akuzuarat nuk kryejnë veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 par.1 dhe 2 të KPP-ës.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.1544/15 të datës 28.07.2016

Procesmbajtësja
Teuta Spahiu

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.